LISTE VERIFIKIMI:
PLANI AFATMESËM I SHKOLLËS
PLANI VJETOR I SHKOLLËS
VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Nr	Instrumente	PO	JO
1	Drejtoria e shkollës ka ngritur grupin qendror për hartimin e planit afatmesëm të shkollës.		
2	Përbërja dhe ndërtimi i grupit qendror është konform kritereve ligjore.		
3	Kontributi i anëtarëve të grupeve të ndryshme (grup qendror, mbështetës, mbikëqyrës) që punojnë për hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e PASH-it është i përfshirë brenda normës zyrtare javore të orëve të punës së mësuesit.		
4	Grupi qendror propozon ekipe mbështetëse me mësues, prindër, nxënës, etj, që lehtësojnë procesin e hartimit dhe të zbatimt të PASH-it.		
5	PASH-i i hartuar respekton formatin dhe elementët konform kërkesave zyrtare.		
6	Struktura e PASH-it përbëhet nga vizioni, analiza e gjendjes, përparësitë, veprimtaritë kryesore, vëzhgimi i procesit të hartimit dhe të zbatimit të planit afatmesëm, buxheti i përafërt.		
7	Analiza e gjendjes së shkollës është e hollësishme dhe e detajuar konform kërkesave ligjore.		
8	Veprimtarië e paraqitura në PASH sigurojnë plotësimin e përparësive dhe objektivave, sepse ato shprehen me anë të objektivave të matshëm dhe me afate të përcaktuara.		
9	Përparësitë e PASH-it nuk mund të jenë më shumë se 3 të tilla, për t'u përmbushur gjatë katër viteve të zbatimit të tij.		
10	Përparësitë e përcaktuara lidhen ngushtë me arritjet e nxënësve të shkollës.		
11	Përparësitë e PASH-it shpallen gjithnjë në një mjedis të dukshëm të shkollës.		
12	Në procesin e hartimit të PASH-it është siguruar një përfshirje dhe bashkëpunim i frytshëm i të gjithë mësuesve, si dhe i grupeve të interesuara për zhvillimin e shkollës, por në veçanti i organizmave kryesore si: Qeveria e Nxënësve, Këshilli i Prindërve të Shkollës.		
13	Koha e përgatitjes së PASH-it fillon me fillimin e vitit të ri shkollor dhe ai dërgohet për miratim te Bordi i shkollës, jo më vonë se 15 prilli i vitit tjetër, brenda këtij viti shkollor.		
14	PASH-i nuk fillon zbatimin e tij pa marrë miratimin tek njësia arsimore vendore.		
15	Vendimi për miratimin e PASH-it, nga njësia arsimore vendore, bëhet jo më vonë se muaji maj i vitit shkollor, kur është hartuar PASH-i.		
16	Për mbikëqyrjen e hartimit dhe zbatimit të PASH-it në shkollë funksionon grupi i mbikëqyrjes, i krijuar nga drejtori i shkollës.		
17	Grupi i mbikëqyrjes përbëhet nga 3 anëtarë.		
18	Grupi i mbikëqyrjes e fillon punën, lidhur me hartimin e PASH-it, që nga		

	fillimi i këtij procesi deri në përfundim të miratimit të PASH-it.		
19	Grupi i mbikëqyrjes ndjek dhe raporton me shkrim çdo 6 muaj te drejtori i shkollës, lidhur me veprimtaritë dhe ecurinë e zbatimit të PASH-it në shkollë.		
20	Kur shikohet e arsyeshme për ndryshime në PASH, ato miratohen te Bordi i shkollës.		
21	PASH-i mundëson zbatimin e tij në plane vjetore, sipas formatit zyrtar të planit vjetor.		
22	Plani vjetor i shkollës përmbush përparësitë e përcaktuara në PASH.		
23	PASH-i ruhet për 8 vite në arkivin e shkollës.		
24	Drejtori i shkollës raporton 1 herë në vit te Bordi i shkollës për zbatimin e PASH-it.		
25	Plani vjetor hartohet dhe zbatohet nga grupe pune që përbëhen nga mësues, prindër, këshillat e prindërve të klasave e të shkollës, nxënës nga qeveria e nxënësve dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti.		
26	Plani vjetor i shkollës, bazohet në planin afatmesëm të saj dhe arritjet e vitit të mëparshëm shkollor.		
27	Plani vjetor i referohet formatit të parashikuar në nenin 67, Dispozitat Normative (procedura e hartimit të planit, analiza e gjendjes, synimi, objektivi (objektivat), veprimtaritë për realizimin e objektivit (objektivave), veprimtaritë për vëzhgimin e zbatimit të planit vjetor, buxheti (nëse ka nevojë për buxhet), raporti i përmbledhur i realizimit të planit vjetor).		
28	Rubrika analiza e gjendjes përfshin të gjitha të dhënat standarde sipas blloqeve të përcaktuara (ndjekja e shkollës, aspekti social, arritjet e nxënësve, treguesit për të cilët shkolla ka arritjet më të larta ose më të ulëta në renditjen në nivel rajonal, etika dhe sjellja, mësuesit, pjesëmarrja në projekte, qëndrimi i klientit).		
29	Për secilën rubrikë të analizës së gjendjes janë përshkruar dy anë të forta dhe të dobëta.		
30	Shkolla bën detajim të veçantë për disa prej treguesve që ajo vlerëson, në rubrika të ndryshme të analizës së gjendjes.		
31	Shkolla bën detajimin e mëtejshëm në tregues specifikë për treguesin për të cilin ka arritur nivelin më të ulët në renditjen e nivelit rajonal.		
32	Në planin vjetor janë përshkruar pjesëmarrja e shkollës në projekte me fondacione, OJF, olimpiada, konkurse, gara dhe renditjen e saj në to.		
33	Shkolla zhvillon pyetësorë për të mundësuar vlerësimin e qëndrimit të nxënësve dhe prindërve ndaj cilësisë së shërbimit të ofruar.		
34	Plani vjetor ka një synim që përshkruan një përparësi të shkollës gjatë një viti shkollor.		
35	Objektivi (objektivat) është rrjedhojë logjike e synimit dhe tregon se në ç’masë do të arrihet synimi gjatë vitit shkollor.		
36	Objektivi (objektivat) përmbush kriteret e përcaktuara për shkrimin e tij (lidhet me arritjet e nxënësve, është i matshëm, mundëson krahasimin e shkollës gjatë viteve dhe nuk nxit ngritjen fiktive të notave) .		
37	Objektivi është i vendosur në mjedise të dukshme të shkollës.		

38	Objektivi i shkollës njihet nga të gjithë grupet e interesit(mësues,nxënës,prindër)		
39	Shkolla, në varësi të problematikave në tërësi, problematikave të cikleve apo paraleleve, harton më shumë se një plan vjetor.		
40	Shkolla ka aq plane vjetore, sa synime përcakton.		
41	Në planin vjetor vendosen vetëm ato veprimtari që i përkasin një synimi të caktuar.		
42	Në planin vjetor përshkruhen veprimtaritë që realizojnë objektivin (objektivat) bashkë me afatet dhe personat përgjegjës.		
43	Drejtoria, në bashkëpunim me grupet e punës, vëzhgon rregullisht realizimin e veprimtarive të parashikuara dhe vlerëson ecurinë e arritjes		
44	Buxheti, nëse është i nevojshëm për një plan vjetor, përmban burimet e financimit dhe shpenzimet sipas veprimtarive.		
45	Plani vjetor i firmosur nga drejtori i shkollës dhe kryetari i bordit, i paraqitet për miratim titullarit të DAR/ZA-së përkatëse.		
46	Plani vjetor është i gatshëm për t'u zbatuar ditën e parë të fillimit të vitit shkollor.		
47	Në shkollë funksionon një grup pune, nën drejtimin e drejtorit të saj, i përbërë nga mësues, përfaqësues nga Këshilli i Prindërve dhe Qeveria e Nxënësve, i cili ka përgjegjësinë e realizimit të vlerësimit të brendshëm.		
48	Shkolla realizon, gjatë një viti shkollor, vlerësimin e brendshëm të 1-2 fushave të udhëzuesit zyrtar të vlerësimit, që miratohen në Këshillin e Mësuesve.		
49	Procesi i vetëvlerësimit të shkollës realizohet gjatë gjithë vitit shkollor, ndërsa kohëzgjatja e tij përcaktohet nga drejtoria e shkollës. Për një fushë procesi i vetëvlerësimit zgjat deri në 3 muaj.		
50	Shkolla përdor për vlerësimin e brendshëm ato fusha, tregues dhe instrumente standard që përdor dhe vlerësimi i jashtëm/inspektimi, të cilat paraqiten zyrtarisht te Udhëzuesi zyrtar i inspektimit të shkollës.		
51	Secili mësues, drejtues, organizëm kryesor i shkollës kryen vetëvlerësimin e tij, duke përdorur metoda dhe instrumente të përzgjedhura nga Këshilli i mësuesve.		
52	Kontributi i mësuesve, drejtuesve të shkollës për procesin e vetëvlerësimit të saj është i përfshirë brenda normës zyrtare javore të orëve të punës së mësuesit dhe drejtuesve të saj.		
53	Mësuesit, organizmat e shkollës, grupi qendror i vlerësimit të brendshëm konsultohen në këtë proces dhe me standardet zyrtare të drejtorit të shkollës, me standardet e përgjithshme, zyrtare të mësuesit, me rezultate të testeve të përdorura nga drejtoria e shkollës, me rezultate të testeve të përdorura nga DAR/ZA-ja, me rezultate të provimeve kombëtare (lirimit apo maturës), me renditjen e shkollës në krahasim me shkollat e tjera.		
54	Procesi i vetëvlerësimit identifikon gjithnjë pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë për përmirësim, si dhe rreziqet që pengojnë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla.		
55	Grupi qendror i Vlerësimit të brendshëm grumbullon të gjithë dokumentacionin e vetëvlerësimit të mësuesve, të drejtuesve dhe të		

	organizmave të shkollës.		
56	Gjatë procesit të vetëvlerësimit të shkollës, mësuesit, drejtuesit, organizmat, grupet e tjera të përfshira në vlerësim, demonstrojnë kulturë, etikë, bashkëpunim të frytshëm, ndershmëri dhe besim.		
57	Grupi qendror mbledh të dhëna vlerësuese nga nxënësit dhe prindërit.		
58	Grupi qendror i Vlerësimit të brendshëm harton një raport të vlerësimit të brendshëm.		
59	Raporti i Vlerësimit të brendshëm përmban: -anët e forta dhe të dobëta mbizotëruese të shkollës, -çështjet mbizotëruese që janë vlerësuar për t'u përmirësuar, -rrugët kryesore për përmirësim të mëtejshëm.		
60	Në raport paraqitet vlerësimi i fushave dhe treguesve, që kanë qenë objekt i vetëvlerësimit, konform vlerësimeve të jashtme, të tilla si: "Sh.mirë' , "Mirë", "Mjaftueshëm" dhe "Dobët".		
61	Grupi qendror i Vlerësimit të brendshëm e paraqet përmbajtjen e raportit te Këshilli i mësuesve, ku së bashku diskutojnë dhe identifikojnë nevojat dhe rrugët për përmirësim të mëtejshëm.		
62	Drejtoria e shkollës ruan në arkivë dokumentacionin e përgatitur gjatë procesit të vetëvlerësimit nga mësuesit, drejtuesit, organizmat e shkollës, apo nga grupe të tjera, për katër vite.		
63	Grupi qendror harton Raportin vjetor të shkollës, jo më shumë se 2 faqe, në të cilin paraqiten të dhëna që merren të sakta nga Raporti i vlerësimit të brendshëm të saj.		
64	Raporti vjetor paraqitet nga grupi qendror te Këshilli i prindërve dhe Qeveria e nxënësve.		
65	Të dhënat e Raportit vjetor paraqiten shumë përmbledhtas dhe lidhen me: -përmbushjen e objektivave të planit vjetor të shkollës, apo shkaqet e mospërmbushjes, -aspektet financiare (kjo vlen për shkollat publike), -risi të suksesshme të identifikuara gjatë procesit mësimor, -bashkëpunimet e suksesshme të shkollës, -certifikata, çmime që kanë fituar nxënësit apo shkolla, -propozime konkrete për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të shkollës, por dhe për nivelin vendor apo kombëtar, arsimor.		
66	Raporti vjetor dërgohet te DAR/ZA-ja, si dhe publikohet në faqen e internetit të shkollës, vetëm pasi të jetë shqyrtuar nga Këshilli i prindërve dhe Qeveria e nxënësve.		
67	Shkolla mundëson Vlerësimin e brendshëm të saj, një herë në katër vite, për të gjithë fushat dhe treguesit e Udhëzuesit zyrtar të inspektimit.		
68	Raporti vjetor i vlerësimit të brendshëm ruhet në arkivën e shkollës për 4 vite.		